

# GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

**Numri i rastit:**

**Pml.Kzz 36/2017**

**Gjykata e Apelit PAKR 52/2014**

**Gjykata Themelore e Prishtinës  
309/2010 dhe**

**P 340/2010**

**Data:**

**15 maj 2017**

## NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata Supreme e Kosovës**, në një trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Anna Bednarek, si kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtare raportuese, gjyqtarja e EULEX-it Iva Niksic dhe gjyqtari i Gjykatës Supreme Enver Peci, si anëtarë të trupit gjykues, të ndihmuar nga zyrtarja ligjore e EULEX-it Kerry Moyes, si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër:

**LD;**

**AD;**

**DJ;**

**IR;**

**SH;**

**IB;**

**SD;**

*Duke vepruar sipas* Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë KMLP.I 6/2017 që Prokurori i Shtetit i Republikës së Kosovës e ka ushtruar më 14 shkurt të vitit 2017 kundër Aktgjyqimit të Gjykatës Supreme Pml Kzz 92/2016 të datës 15 dhjetor 2016 (në tekstin e mëtejme “aktgjykimi i kundërshtuar”);

*Pasi e ka shqyrtuar* përgjigjen e mbrojtësit Petrit Dushi të paraqitur në emër të të pandehurit **AD** më 13 mars të vitit 2017 dhe përgjigjen e mbrojtësit Valon Hasani të paraqitur në emër të të pandehurit **LD** më 23 mars të vitit 2017;

*Pasi është këshilluar dhe ka votuar* më 15 maj të vitit 2017;

sipas neneve 432 dhe 435 të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejshëm “KPP-së”)

merr këtë:

---

## AKTVENDIM

---

**Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e regjistruar me numrin KMLP.I 6/2017 që Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës e ka ushtruar më 14 shkurt të vitit 2017 kundër Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës që është marrë në rastin Pml Kzz 92/2016 më 15 dhjetor të vitit 2016 hudhet si e papranueshme.**

## ARSYETIM

### 1. HISTORIKU RELEVANT PROCEDURAL

Aktakuza PPS Nr 41/09 është ngritur kundër të pandehurve **LD, AD, DJ, IR** dhe **SH** më 15 tetor të vitit 2010. Më 20 tetor të vitit 2010, Aktakuza PPS Nr. 107/10 është ngritur kundër të pandehurve **IB** dhe **SD**. Të dyja aktakuzat janë bashkuar në një aktakuzë të vetme më 29 nëntor të vitit 2010 dhe janë konfirmuar më 27 prill të vitit 2011.

Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 4 tetor të vitit 2011 dhe është përfunduar më 24 prill të vitit 2013. Ai është mbajtur para një trupi gjykues të përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar vendor. Më 18 maj të vitit 2012, gjyqtari vendor është zëvendësuar. Më 22 mars të vitit 2013 dhe 17 prill të vitit 2013, aktakuza është ndryshuar dhe zgjeruar. Sipas aktakuzës përfundimtare, të pandehurit janë akuzuar për sa vijon:

PIKA 1:                    **LD, AD dhe SH**  
Trafikimi me njerëz në bashkëkryerje sipas neneve 139 dhe 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm “KPPK-së”)

PIKA 2:                    **LD**  
Krimi i organizuar sipas nenit 274 (3) të KPPK-së

- PIKA 3: **AD dhe SH**  
Krimi i organizuar sipas nenit 274 (1) të KPPK-së
- PIKA 4: **LD, DJ, IB, SD dhe SH**  
Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore në bashkëkryerje sipas neneve 221 (1) dhe 23 të KPPK-së
- PIKA 5: **DJ**  
Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit sipas nenit 339 (1) të KPPK-së
- PIKA 6: **IR**  
Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit sipas nenit 339 (1) të KPPK-së
- PIKA 7: **LD, SH, IB, SD dhe AD**  
Lëndimi i rëndë trupor në bashkëkryerje sipas neneve 154 dhe 23 të KPPK-së
- PIKA 8: **LD dhe AD**  
Mashtrimi sipas nenit 261 të KPPK-së
- PIKA 9: **LD dhe AD**  
Falsifikimi i dokumenteve sipas nenit 332 (1) të KPPK-së
- PIKA 10: **IR**  
Falsifikimi i dokumenteve zyrtare sipas nenit 348 të KPPK-së

Më 29 prill të vitit 2013, Gjykata Themelore e Prishtinës e ka shpallur aktgjykimin e saj, me të cilin:

- a. **LD** është dënuar për veprat penale të trafikimit me njerëz të kryer në bashkëkryerje (pika 1 e aktakuzës) dhe krimit të organizuar (pika 2 e aktakuzës). Ai është dënuar me tetë vite burgim dhe është gjobitur me 10,000 euro. Ndaj tij është shqiptuar dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të profesionit të urologut për një periudhë prej dy vitesh. Akuzat për ushtrim të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore, lëndim të rëndë trupor, mashtrim dhe falsifikim të dokumenteve (pikat 4 dhe 7-9 të aktakuzës) janë refuzuar.
- b. **AD** është dënuar për veprat penale të trafikimit me njerëz të kryer në bashkëkryerje (pika 1 e aktakuzës) dhe krimit të organizuar (pika 3 e aktakuzës). Ai është dënuar me shtatë vite e tre muaj burgim dhe është gjobitur me 2,500 euro. Ai është liruar nga

akuza për lëndim të rëndë trupor (pika 7 e aktakuzës). Akuzat për mashtrim dhe falsifikim të dokumenteve (pikat 8 dhe 9 të aktakuzës) janë refuzuar.

- c. **SH** është liruar nga akuza për krim të organizuar (pika 3 e aktakuzës) dhe është dënuar për veprën penale të lëndimit të rëndë trupor (pika 7 e aktakuzës). Ai është dënuar me tri vite burgim. Atij i është shqiptuar dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të profesionit të anesteziologut për një vit. Akuzat për trafikim me njerëz dhe ushtrim të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore (pikat 1 dhe 4 të aktakuzës) janë refuzuar.
- d. **IB** është dënuar për veprën penale të lëndimit të rëndë trupor (pika 7 e aktakuzës) dhe është dënuar me një vit burgim me kusht. Akuza për ushtrim të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore (pika 4 e aktakuzës) është refuzuar.
- e. **SD** është dënuar për veprën penale të lëndimit të rëndë trupor (pika 7 e aktakuzës) dhe është dënuar me një vit burgim me kusht. Akuza për ushtrim të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore (pika 4 e aktakuzës) është refuzuar.
- f. **DJ**: Akuzat për ushtrim të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore dhe shpërdorim të pozitës zyrtare ose autorizimit (pikat 4 dhe 5 të aktakuzës) janë refuzuar.
- g. **IR** është liruar nga akuza për shpërdorim të pozitës zyrtare ose autorizimit (pika 6 e aktakuzës). Akuza për falsifikim të dokumenteve zyrtare (pika 1 e aktakuzës) është refuzuar.

Me anë të aktvendimit të ndarë të datës 25 nëntor të vitit 2013, Gjykata Themelore e ka urdhëruar mbylljen dhe konfiskimin e klinikës “Medicus”.

Mbrojtësit e **LD, AD, SH, IB** dhe **SD** dhe prokurori kanë ushtruar ankesë kundër aktvendimit të datës 25 nëntor të vitit 2013 dhe aktgjykimit të datës 29 prill të vitit 2013. Me aktgjykimin që është marrë në rastin PAKR 52/2014 të datës 6 nëntor 2015, Gjykata e Apelit i ka aprovuar pjesërisht ankesat që janë ngritur në emër të të pandehurve dhe e ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

I pandehuri **SH**, së bashku me mbrojtësin e tij, dhe i pandehuri **LD** kanë ushtruar ankesa pranë Gjykatës Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Ankesa që e ka ushtruar **LD** është hedhur si e papranueshme me anë të një aktvendimi. Gjykata Supreme ka marrë aktgjykim në rastin PAII-KZII-2/2016 më 20 shtator të vitit 2016, përmes të cilit e ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar mbrojtësi Petrit Dushi, në emër të **AD**, mbrojtësit në emër të **LD** dhe Kryeprokurori i Shtetit. Me aktgjykimin e kundërshtuar, Gjykata Supreme e ka hedhur poshtë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë që e ka ushtruar Kryeprokurori i Shtetit si të paafatshme, ndërsa i ka aprovuar pjesërisht kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë që i kanë ushtruar mbrojtësit për **AD** dhe **LD**. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës i datës 29 prill 2013, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit i datës 6 nëntor 2015 dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme i datës 20 shtator 2016 janë anuluar pjesërisht dhe rasti i është kthyer Gjykatës Themelore të Prishtinës për rigjykim.

## 2. PARASHITESAT E PALËVE

### 2.1 Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë që është ushtruar nga prokurori i shtetit

Prokurori i shtetit thekson se aktgjykimi i kundërshtuar përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, siç është paraparë me nenin 384 (1), dhe të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor sipas nenit 432 (1) të KPP-së dhe për shkak të çfarëdo shkeljeje të ligjit sipas nenit 432 (1.3) të KPP-së.

Prokurori i shtetit bën me dije se, sipas aktgjykimit të kundërshtuar, aktgjykimi i Gjykatës Themelore ka përbërë shkelje të nenit 384 (1.2), në lidhje me nenin 40 (2.1) të KPPPK-së, sepse kryetarja e trupit gjykues duhej të ishte përjashtuar nga pjesëmarrja në shqyrtimin gjyqësor. Gjykata Supreme ka gjetur se kjo shkelje ka qenë aq e rëndë sa që thjesht nuk mund t'i ndryshojë aktgjykimet apo të kufizohet me vërtetimin e shkeljes dhe i ka anuluar dënimet që janë shqiptuar nga shkallët e mëparshme. Prokurori i shtetit potencon se kjo çështje i është bërë me dije Gjykatës Supreme disa herë dhe i citon një numër vendimesh<sup>1</sup> dhe se aktgjykimi i kundërshtuar është në kundërshtim të thellë me praktikën e mëparshme të Gjykatës Supreme në interpretimin ligjor të saj për këtë pikë. Veç kësaj, Gjykata Supreme nuk ka shtjelluar se si shkelja e kodit të procedurës ka ndikuar negativisht në të pandehurit dhe/ose në drejtësinë e gjykimit në çfarëdo mënyre. Prokurori i shtetit përfundon se Gjykata Supreme e ka shkelur ligjin procedural dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse nuk i ka theksuar qartë dhe në mënyrë shteruese arsyet për përcaktimin e këtyre çështjeve ligjore. Përndryshe aludohet se përbërja e trupit gjykues që e ka marrë aktgjykimin e kundërshtuar – anëtare të të cilit kanë qenë gjyqtarja Emine Mustafa, e cila më parë ka vendosur për kërkesën e prokurorit për zgjatje të hetimit në të njëjtin rast, si dhe gjyqtaret Emine Mustafa dhe Elka Filcheva-Ermenkova, të cilat kanë vendosur për kërkesën e mbrojtësit për ta pezulluar zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit – Gjykata Supreme e ka shkelur parimin e njëjtë që e ka pohuar në aktgjykimin e kundërshtuar.

Prokurori i shtetit vëren se, sipas aktgjykimit të kundërshtuar, zëvendësimi i njërit anëtar të trupit gjykues është bërë pa marrjen e një aktvendimi për shtyrjen e gjykimit dhe pa e rinisur gjykimin nga fillimi dhe se kjo pastaj përbën shkelje të së drejtës së të pandehurit në gjykim të drejtë. Prokurori i shtetit pajtohet me argumentet që gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova i ka paraqitur në mendimin mospajtues të saj për këtë pikë.

Prokurori i shtetit sugjeron se kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë që janë paraqitur në emër të të pandehurve **LD** dhe **AD** janë paraqitur para se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të merrte formë të prerë, prandaj duhej të ishin hedhur si të papranueshme. Ai nuk pajtohet me arsyetimin e Gjykatës Supreme për këtë çështje, ndërsa thekson se Gjykata Supreme nuk ka

---

<sup>1</sup> Aktgjykimi AP 371/08 i datës 10 prill 2009; Aktgjykimi PKL 71/09 i datës 10 nëntor 2009; Aktvendimi PML 64/2014.

qenë konsistente kur e ka zbatuar një interpretim të rreptë dhe të fjalëpërfjalshëm të ligjit. Gjykata Supreme ka qenë e rreptë sa i përket përbërjes së trupit gjykues të parë, fleksibile sa i përket pranueshmërisë së kërkesave që i kanë ushtruar të pandehurit dhe e rreptë përsëri sa i përket kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë që e ka ushtruar prokurori i shtetit dhe që është hedhur si e paafatshme.

Prokurori i shtetit i propozon Gjykatës Supreme që të shpallë se aktgjykimi i kundërshtuar:

- a. ka përbërë shkelje të dispozitës së nenit 384, paragrafit 1.12, në lidhje me nenin 370, paragrafin 7, dhe nenin 44 të KPP-së si dhe nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse në të nuk janë treguar qartë dhe në mënyrë shteruese arsyet për të cilat ka qenë e udhëzuar që t'i përcaktonte çështjet ligjore të lartpërmendura;
- b. ka përbërë shkelje të dispozitës së nenit 384, paragrafit 2, në lidhje me nenin 9 (barazia e palëve), dhe nenit 433, paragrafit 2 (pranueshmëria e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë) të KPP-së;
- c. ka përbërë shkelje të parimit të njëjtë që e ka pohuar në aktgjykimin e kundërshtuar duke e shkelur dispozitën e nenit 384 (1.2) të KPP-së në lidhje me nenin 39, paragrafin 2 të KPP-së.

## 2.2 Përgjigjet

Mbrojtësi Petrit Dushi, në emër të të mbrojturit të tij **AD**, ka paraqitur përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë që e ka dorëzuar prokurori i shtetit. Ai thekson se bërja e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga prokurori i shtetit në këto rrethana bie ndesh me praktikën gjyqësore të Kosovës. Për më tepër, prokurori i shtetit nuk ka ofruar ndonjë provë apo fakt që konfirmon se në aktgjykimin e kundërshtuar gjendja faktike është vërtetuar gabimisht si dhe nuk ka ofruar prova dhe fakte që do të shërbenin për ta vërtetuar shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale. Mbrojtësi kërkon që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë që e ka ushtruar prokurori special të refuzohet nga Gjykata Supreme si e pabazuar.

Mbrojtësi Valon Hasani ka paraqitur përgjigje në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë më 23 mars të vitit 2017. Z. Hasani në përgjigjen e tij nuk thekson se cilin të pandehur e përfaqëson, megjithatë Gjykata Supreme është e vetëdijshme nëpërmjet komunikimeve të mëparshme se ai e përfaqëson **LD**. Prandaj, Gjykata Supreme e pranon përgjigjen e tij si të paraqitur në emër të **LD**. Ky mbrojtës thekson se në nenin 432, paragrafin 2 të KPP-së përcaktohet se kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet kundër një vendimi të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilin është vendosur për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Prandaj, kjo kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë është e ndaluar me ligj dhe duhet të hudhet si e papranueshme. Veç kësaj, ajo është e pabazuar. Është brenda kufijve të vlerësimit të shteteve që të japin më shumë garanci procedurale se sa që garantohen me KEDNJ. Për më tepër, rregullat e procedurës në këtë rast janë shkelur disa herë në dëm të të pandehurit. Mbrojtësit po ashtu nënvijëzojnë se prokurori gjatë seancës për shqyrtimin e paraburgimit ka deklaruar se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit ka qenë i formës së prerë. Tani ata e kanë e

ndryshuar qëndrimin e tyre dhe po theksojnë se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk ka qenë i formës së prerë, meqë ka qenë objekt i një ankese që është ushtruar nga të pandehurit **LD** dhe **SH**. Ai kërkon që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të hudhet si e papranueshme.

### **3. GJETJET E GJYKATËS SUPREME**

#### **3.1 Ligjet procedurale të aplikueshme**

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është ushtruar pasi ka hyrë në fuqi KPP (i ri), më 1 janar të vitit 2013. Prandaj, sipas nenit 539 të KPP-së, procedura e Gjykatës Supreme qeveriset nga KPP-ja.

#### **3.2 Pranueshmëria**

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë që e ka ushtruar prokurori i shtetit është e papranueshme. Trupi gjykues e bën me dije përmbajtjen e nenit 432 të KPP-së të titulluar “arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë”. Prokurori i shtetit kërkesën e tij e bazon në nenin 432, paragrafin 3 të KPP-së, në të cilin parashihet se:

*“Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, Kryeprokurori i Shtetit mund të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për cilëndo shkelje ligjore”.*

Megjithatë, trupi gjykues e bën me dije nenin 432, paragrafin 2 të KPP-së, në të cilin thuhet:

*“Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë”.*

(shenjat e theksimit janë shtuar).

Prandaj, trupi gjykues përfundon se autoriteti i Kryeprokurori i Shtetit për të ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të çfarëdo shkeljeje të ligjit nuk e përfshin autoritetin për ta bërë këtë kundër ndonjë aktgjykimi të Gjykatës Supreme me të cilin është vendosur për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Trupi gjykues është i mendimit se kjo është e qartë nga formulimi i nenit 432, paragrafëve 1, 2 dhe 3 të KPP-së, dhe se në të theksohet qartë qëllimi i ligjbërësit për këtë çështje. Një analizë e thukët e përmbajtjes së paragrafit 3 shpie në përfundimin se qëllimi i ligjvënësit ka qenë që t’i shtonte arsyet që janë radhitur në paragrafin 1 të nenit 432 të KPP-së e jo që Kryeprokurori i Shtetit t’ia jepte autoritetin për të ushtruar kërkesa të mëtejme për mbrojtjen e ligjshmërisë, pavarësisht kufizimeve që janë shprehur në fjalinë e fundit të paragrafit 2 të nenit 432 të KPP-së. Si rrjedhojë, papranueshmëria e kërkesës e bën të domosdoshme që trupi gjykues t’i shqyrtojë argumentet që i ka dorëzuar prokurori i shtetit në lidhje me meritat.

Për arsytet e lartpërmendura, vendoset si në dispozitiv.

**Kryetarja e trupit gjykues:**

---

Anna Bednarek  
Gjyqtare e EULEX-it

**Procesmbajtësja:**

---

Kerry Moyes  
Zyrtare Ligjore e EULEX-it

**Anëtarët e trupit gjykues:**

---

Iva Niksic  
Gjyqtare e EULEX-it

---

Enver Peci  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme